



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 15.01.2009 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N.225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Fatmire Berisha, Adem Hajdaraj, Hestet Cakolli, Memli Krasniqi, Gani Buçinca dhe Mark Krasniqi .

Munguan: Enis Kervan, Donika Kadaj-Bujupi dhe Dragan Dimiq

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Plani i punës së Komisionit për vitin 2009**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 23.12.2008 me përmirësimin në konstatimin e pikës të ndryshme.

2. Plani i punës së Komisionit për vitin 2009

Agim Veliu, kryetar lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se si Komision duhet të bisedojmë në parim se çka do duhej të përmbajë plani i punës i cili paraprakisht do të jetë i varur nga strategjia legislative e Qeverisë për vitin 2009.

Komisioni duhet të përcaktojë një lloj dinamike të punës të përcaktohen prioritetet e punës që janë në kompetencë të tij.

Në vijim diskutuan anëtarët e Komisionit.

Drita Kadriu lidhur me këtë çështje ka përgatitur një plan të punës i cili do të shërbejë Komisionit me qëllim të koordinimit të punëve. Ky plan i parasheh aktivitetet dhe veprimet që do të ndërmer Komisioni veqmas në monitorimin e ligjeve si dhe takimet me përfaqësues të ndryshëm të Institucioneve relevante.

Ajo theksoi se Komisioni duhet të përqëndrohet në tri aktivitete të punës.

Aktiviteti në shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve, në monitorimin e zbatimit të tyre si dhe të realizohen vizita në Institucione me qëllim të marrjes së informatave në çështjen e monitorimit të ligjeve të miratuara dhe shkëmbimit të përvojave me qëllim të organizimit të punëve të Komisionit.

Lidhur me këtë duhet konkretizuar puna dhe të përcaktohet koha e punës së Komisionit me qëllim të organizimit të takimeve me Institucionet e ndryshme.

Heset Cakolli dokumentin e propozuar nga Drita e cilësoi si dokument voluminoz ku mes tjerash parashihet edhe mundësia e monitorimit të ligjeve. Ne si Komision duhet të veprojme sipas planit të Qeverisë si dhe të organizohemi për monitorim të ligjeve në praktikë.

Mark Krasniqi mendon se do duhej të shiqohen prioritetet cilat janë çështjet që janë me prioritet dhe cilat ligje do duhet monitorohen.

Gani Buçinca vlerëson se në kuadër të monitorimit të ligjeve duhet krijuar prioritetet për ligje të caktuara në këtë aspekt përmendi Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta si një ligj i cili nuk po zbatohet në praktikë dhe se për këtë çështje Komisioni duhet ta ftuojë ministrin në mënyrë që të shiqohet pse nuk po zbatohet ky Ligj në praktikë.

Ai mendon se duhet shqyrtuar dhe monitoruar edhe Ligjin për veprimtarinë botuese dhe librin dhe se duhet bërë ndryshim në heqjen e TVSH-së për botimin e librit.

Gjithashtu në kuadër të monitorimit përmendi edhe Ligji për operën dhe baletin ku do duhej të ftohen ekspertët e kësaj veprimtarie.

Adem Hajdaraj lidhur me këtë pikë tha se duhet shiquar planet e punës së dy ministrive që i mbulon Komisioni si dhe duhet filluar me monitorimin e zbatimit të ligjeve.

Agim Veliu, kryetar, konstatoi se se Komisioni duhet të përqëndrohet në tri prioritete të punës e që janë:
Prioriteti në shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve, në monitorimin e zbatimit të tyre si dhe të realizohen vizita në Institucione me qëllim të marrjes së informatave në çështjen e monitorimit të ligjeve.

Komisioni lidhur me planin e punës për vitin 2009, konstatoi se duhet të punojë sipas tri prioriteteve e që janë lidhura me fushëveprimtarinë e Komisionit, andaj nxorri këtë :

P ë r f u n d i m

- prioriteti i parë i Komisionit për vitin 2009 është shqyrtimi dhe amendamentimi i projektligjeve,
- prioritet apo aktivitet i dytë është shqyrtimi i monitorimit të ligjeve në praktikë dhe
- aktiviteti i tretë parashihen vizitat që planifikohen të realizohen në Institucione brenda dhe jashtë vendit.

Plani i punës së Komisionit për vitin 2009 duhet të jetë në pajtim me strategjinë legjislative të Qeverisë me këtë rast u kërkua nga stafi mbështetës i Komisionit që për mbledhjen e ardhshme të hartojë një plan të punës në të cilin duhet të inkorporohet strategjia legjislative e Qeverisë si dhe prioritetet e Komisionit.

Memli Krasniqi përkrah propozimin e hartuar nga Drita si dhe prioritetet e propozuara nga Komisioni. Ai vlerëson se lidhur me procesin e monitorimit duhet krijuar prioritetet se cilat ligje do të monitorohen, në këtë aspekt do të kontribuonte shumë edhe mbajtja e dëgjimeve publike.

3. Të ndryshme

Komisioni shqyrtoi kërkesën nga Departamenti i Rinisë për takim pune me Komisionin lidhur me hartimin e Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje për rini, dhe lidhur me këtë konstatoi se me rregullat e punës së Kuvendit nuk parashihet një gjë e tillë.

Për mbledhjen e ardhshme Komisioni konsideron se duhet ftuar Ministrin e Kulturës Rinisë e Sportit për të debatuar lidhur me implementimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00

Kryetari i Komisionit,

Agim VELIU